



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-25-3063-1-3-6/C1044
14 Nr. 450/25
Dt. 12.06.2025

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i ZPP-së** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**) dhe
2. **BMS SOLUTIONS L.L.C., Mehmet Akifi nr .14, 42000, Vushtrri, Kosovë, emri i tregtar/, emri biznesit BMS SOLUTIONS L.L.C, me seli në Vushtrri, me ARBK : 811557711, të cilën e përfaqëson z. Shpëtim Kajtazi, në tekstin e mëtejme: FURNIZUESI,**

, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë: **Furnizim me lodra për fëmijë sipas lot 2, me numër identifikues:**

Nr. i prokurimit	VU644	2	5	30	6	3	1	3	6
Nr. i brendshëm	VU644	2	5	0	2	2	1	3	6

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizim me lodra për fëmijë sipas lot 2, ashtu sikurse është specifikuar ne Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme pjesë e Dosjes së Tenderit.**
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit: jo më gjatë se 10 ditë pas datës së nënshkrimit të kontratës.
- 1.3 Vendi i dërgimit do të jetë : **Institucionet parafillore -Foleja dhe Foleja 2**
- 1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2

Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3

Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,058.50€**; [njëmijepesëdhjetetë/50] Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 4

Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pasi që Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit i Autoritetit Kontraktues të konfirmoi me shkrim pranim-Furnizim me lodra për fëmijë sipas lot 2, respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se Furnizim me lodra për fëmijë sipas lot 2 është dorëzuar – pranuar nga A.K. , si në aspektin teknik dhe në aspektin cilësor. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit/Furnizuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimin dhe / ose shërbimin e përfunduar.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6

Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimit dhe / ose shërbimit është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisa e dorëzuar duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7

Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimit dhe / ose shërbimit të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 8 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 9 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 13 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;

- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.





3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:

KOMUNA E VUSHTRRIË.

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë

Emri:	Burim Plakolli	Emri:	Ilmi Azemi
Pozita:	Drejtor ekzekutiv	Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	12.06.2025	Data:	12.06.2025
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr455/25
Dt. 13.06.2025

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 43 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë si dhe në pajtimit me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik / Nr.A01, në bashkëpunim dhe propozim dhe të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese DSHP-së dhe ZPP-së, më dt. 13.06.2025 merrë:

V E N D I M

Emërohet Menaxherë i kontratës përmbushjen në mënyrë të rregullt të kontratës që për lëndë ka: "Furnizim me lodra për fëmijë për lot 1 dhe lot 2 ", me numër të prokurimit: VU644-25-3063-1-3-6 dhe numër të brendshëm të prokurimit VU644-25-22-136, si vijon :

Z.Ardian Jashari, emërohet menaxher i kontratës.
Z.Alban Tahiraj, emërohet mbikëqyrës i drejtpërdrejt imenaxherit të kontratës.

1. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 61 të Rregullave dhe Udhëheqësit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Projektit / Kontratës, janë me sa vijon, të :

- Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
- Dorëzoj raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontratë, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor administrativ;
- Në pajtim me nenin 61.7 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës i A. K. duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të projektit / Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i projektit/ kontratës brenda afatit optimal/ të arsyeshëm kohorë, jo më gjatë se dy ditë pune, duhet të krijoj një Plan për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin " Fillimi / rimbilizimi i kontratës". Plani i menaxhimit të kontratës do të krijohet nga Sistemi i prokurimit elektronik në bashkëpunim mes Menaxherit të kontratës të A.K. dhe O.E. - Kontraktuesit, duke e nënshkruar të dyja palët. Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menaxhim të kontratës, Menaxheri i Projektit do të lëshoi Op. Ek. kontraktuesit letrën për fillimin e punëve, kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të


kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë me sa vijon:

- mbikëqyrja e drejtpërdrejtë e implementimit të kontratës;
 - administrimi i plotë i kontratës, përfshirë çfarëdo ndryshimi eventuale të kontratës, dhe
 - rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit- vlerësime të propozuar nga menaxheri i kontratës nën mbikëqyrjen e tij.
2. Për Komision të Pranimit të mallit të porositur dhe të furnizuar sipas projektit njësitë kërkuese duhet të formojnë nga një komision ad-hoc.
4. Komisioni, si në nenin 3 të këtij Vendimi, secili për pjesën e tij të përgjegjësisë, ka për detyrë të bëjë kontrollin cilësorë dhe sasiorë të furnizimeve dhe / ose shërbimeve sipas Kërkesës – Porosisë për blerje të Njësisë Kërkuese të cilën e përfaqëson, si dhe pranimin e mallit të dorëzuar, ku kryes i furnizimeve për materialin sipas përshkrimit “Furnizim me lodra për fëmijë lot 1 dhe lot 2 “ është OE : “4ING për lot 1 dhe BMS SOLUTION për lot 2 në bazë të kontratës nr. C/1043 me datë 12.06.2025 për lot 1 dhe C/1044 për lot 2 .
5. Komisioni do të filloi me punë me të pranuar të këtij Aktvendimi ndërsa do të bashkëpunoi ngushtë, në çdo kohë, me Menaxherin e Kontratës të Njësisë Shpenzuese gjegjëse si dhe Menaxherin e Kontratës të Kontraktuesit.
6. Nëse Komisioni konstaton të meta dhe/ ose parregullësi në cilësinë ose përshtatshmërinë e mallit të dorëzuar, atëherë Komisioni do të caktoj afatin për mënjanimin e parregullsive dhe / ose mangësive të konstatuara dhe të pranoi mallin pas mënjimit të mangësive të konstatuara.
7. Nëse komisioni konstaton se nuk ka të meta, atëherë do të hartoi **Raport në të cili do të konfirmoi** përfundimin e furnizimeve të Porositura , të cilin, të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit dhe Menaxheri i Kontratës, në afatin më të shkurtë kohorë do t’ia dërgoi, një kopje Kryesit të furnizimeve, ndërsa një kopje Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, me qëllim të procedimit të mëtejshëm.
8. Vendimi hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marrjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin e përpiktë të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – **Komunës së Vushtrrisë** dhe Operatorëve Ekonomik

Kopje: 1 x 1 Menaxheri i Kontratës;
1 x 1 Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës;
1 x 1 Komisionit të pranimit të mallit;
1 x 1 Drejtorisë së Prokurimit.

Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm Kolonat F dhe G Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%-8%-apo-18%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëves dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
I Përshkrimi									
1	Arush Polar Plastik	copë	10.00	2.54	18.00	3.00	25.42	4.58	30.00
2	Blister Peshkimi - 12 Cope	copë	6.00	2.54	18.00	3.00	15.25	2.75	18.00
3	Kafshe Ferme Ne Kufi Kartoni 6cope	copë	4.00	2.54	18.00	3.00	10.17	1.83	12.00
4	Kafshe Ferme Plastike te ndryshme	copë	20.00	2.54	18.00	3.00	50.85	9.15	60.00
5	Kartel Doktori 7Cp	copë	6.00	2.54	18.00	3.00	15.25	2.75	18.00
6	Kaskete Policie Me Mbrojtese	copë	4.00	2.54	18.00	3.00	10.17	1.83	12.00
7	Kosh per Pazar Me Fruta	copë	4.00	2.54	18.00	3.00	10.17	1.83	12.00
8	Kosh Per Pazar Zarzavate	copë	4.00	3.39	18.00	4.00	13.56	2.44	16.00
9	Kove Me Tulla Shumengjyreshe 144 Cope	copë	4.00	2.97	18.00	3.50	11.86	2.14	14.00
10	Aeroplan Loder	copë	6.00	2.54	18.00	3.00	15.25	2.75	18.00
11	Loder Ambulance	copë	6.00	2.54	18.00	3.00	15.25	2.75	18.00
12	Loje Tavoline Mini , loder nga druri	copë	6.00	2.54	18.00	3.00	15.25	2.75	18.00
13	Piano Ksilof Mini Kuqe	copë	4.00	2.12	18.00	2.50	8.47	1.53	10.00
14	Pazell Druri me Numra dhe Figura 30X30cm	copë	3.00	2.12	18.00	2.50	6.36	1.14	7.50
15	Pazell Druri Me Fruta 30X22cm	copë	3.00	2.54	18.00	3.00	7.63	1.37	9.00
16	Vezë për bebe me tricikletë me këllëf	copë	6.00	4.24	18.00	5.00	25.42	4.58	30.00
17	Loje edukative me topa numerimi per femije	copë	4.00	4.24	18.00	5.00	16.95	3.05	20.00
18	Loder formuese per beba 13 cp	copë	6.00	4.24	18.00	5.00	25.42	4.58	30.00
19	Loder elefant me 4 rota 11.5x12x4.5	copë	20.00	4.24	18.00	5.00	84.75	15.25	100.00
20	Piramide Me 5 Unaza Me Rose	copë	4.00	2.97	18.00	3.50	11.86	2.14	14.00
21	Pistoletë Me Uje Me Filuska	copë	20.00	5.08	18.00	6.00	101.69	18.31	120.00
22	Set Caji Lejja Dhe Roze 11 Cope Cupcakes	copë	6.00	1.69	18.00	2.00	10.17	1.83	12.00

23	Set Me 9 Aksessore Kuzhine	copë	6.00	1.69	18.00	2.00	10.17	1.83	12.00	
24	Set Me Forma Per Embelsira	copë	6.00	7.63	18.00	9.00	45.76	8.24	54.00	
25	Set Ushqimi Dhe Pica 50Cp	copë	6.00	0.85	18.00	1.00	5.08	0.92	6.00	
26	Shtepi Me Muzike Zera Kafshes	copë	10.00	4.24	18.00	5.00	42.37	7.63	50.00	
27	Top I Bute Bardhezi	copë	10.00	0.85	18.00	1.00	8.47	1.53	10.00	
28	Varesse Karroce Me Arush Blu	copë	12.00	1.69	18.00	2.00	20.34	3.66	24.00	
29	Kostum Policie Me Aksessore	copë	2.00	2.97	18.00	3.50	5.93	1.07	7.00	
30	Uniforme Me Vegla Mjeku	copë	2.00	3.39	18.00	4.00	6.78	1.22	8.00	
31	Loder ne forme ore me kafshe 25 cm	copë	6.00	2.54	18.00	3.00	15.25	2.75	18.00	
32	Loder happy mouth me dhembte te bardhe	copë	4.00	2.12	18.00	2.50	8.47	1.53	10.00	
33	Lodër me top që hidhet në ajër dhe bën kosh, 2 copë	copë	10.00	2.54	18.00	3.00	25.42	4.58	30.00	
34	Loje domino me 100 tullia me ngjyra te ndryshme 4+	copë	6.00	2.12	18.00	2.50	12.71	2.29	15.00	
35	Numëratore Druri E Vogël Për Fëmijë 16x21 Cm	copë	20.00	2.12	18.00	2.50	42.37	7.63	50.00	
36	Topa plastik 50 cp ne rrejt 6 cm	copë	10.00	2.54	18.00	3.00	25.42	4.58	30.00	
37	Tapet me designe autostrade 100x150cm	copë	2.00	2.54	18.00	3.00	5.08	0.92	6.00	
38	Edukative piramid me 5 disqe dhe gjirafe 14x10 6cp	copë	10.00	2.54	18.00	3.00	25.42	4.58	30.00	
39	Kosh lavanderie për fëmijë me panda 30x40cm	copë	20.00	4.24	18.00	5.00	84.75	15.25	100.00	
								897.03	161.47	1,058.50

TOTALI I VLERES SE PERGJITHSHME ME TVSH:

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)

EMRI I OE:	BMS SOLUTIONS L., L.C.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT	BURIM PLAKOLLI
NËNSHKRIMI:	
DATA:	25.04.2025
VULA:	